



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.10.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar”.

Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------|---------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (kryetar) |
| 2. Yllka Rupa | (zëvendëskryetare) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 8. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Violanda Theodhori | (anëtar) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Luan Dibra (në sallë), Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese EWMI.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice(në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar”.

Ilir Rusi: Mirëdita të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë, sot është mbledhja e radhës e Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 29.10.2024, ora 11:00.

Për shkak të disa diskutimeve mbledhja po fillon në këtë orë.

Ndërkohë që kuorumi është i nevojshëm. Janë të 11 (njëmbëdhjetë) anëtarët prezent.

Mbledhja drejtohet sot nga unë Ilir Rusi, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me këtë rast ju uroj punë të mbarë së bashku në realizimin e misionit që kemi si Këshill i Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me rendin e ditës ju është bërë me dije. Për shkak të funksionalitetit janë përcaktuar këto pika, me qëllim që të ketë një vijueshmëri në lidhje me funksionet që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Keni diskutime për rendin e ditës?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Atëherë vazhdojmë me pikën e parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar. Është një akt i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Në referim të nenit 62 të ligjit nr.115/2016 “Për qeverisjen”, ku parashikohet që pas zgjedhjes së kryetarit, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.13, datë 18.01.2019 “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme” janë krijuar dhe funksionojnë 4 (katër) Komisione të Përhershme, si më poshtë:

- a) Komisioni i Planifikimit Strategjik [...];
- b) Komisioni Disiplinor;
- c) Komisioni i Vlerësimit të Etikës [...];
- ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Duke marrë parasysh përbërjen e Këshillit, me anëtarë gjyqtarë dhe jogjyqtarë, numrin e anëtarëve është 11, si dhe nevoja për ndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, ligjvënësi ka parashikuar që çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë, si dhe në dispozicion të çdo Komisioni edhe 2 anëtarë zëvendësues.

Në përbërjen e Komisioneve duhet mbajtur në konsideratë, që anëtarët nuk duhet të marrin pjesë në jo më shumë se dy komisione, çka sjell që anëtarët të kenë një shpërndarje në të gjithë komisionet si dhe bëhet e mundur jo vetëm ngritja por dhe funksionimi i secilit komision.

Ndaj sa më sipër, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë ngritur Komisionet e Përhershme:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

Në përbërje me 3 anëtarë (anëtarë 2 jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar).

2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar jogjyqtar dhe 1 anëtar gjyqtar).

2. Komisioni Disiplinor

Në përbërje me 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).

2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).

3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

Në përbërje me 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).

2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).

Anëtarët e këtij komisioni nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

Ka në përbërje 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).

2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).

Anëtarët e këtij komisioni nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Sipas nenit 62 të ligjit të sipërcituar, shpërndarja e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues në Komisione bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë.

Gjithashtu, për sa është e mundur në ndarjen e anëtarëve në komisione duhet të mbahen në konsideratë: i) Preferencën e anëtarëve të Këshillit; ii) Eksperiencën e tyre në raport me fushën e veprimtarisë së Komisionit.

Pra, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin e tij nr.13, datë 18.01.2019 vendosi lidhur me ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Këshillit. Ky vendim, sipas ripërtëritjes së mëvonshme të KLGJ-së me anëtarë të rinj (në fund të vitit 2021, në fillim të vitit 2022, [...]) - s'po i lexoj këto më tej.

Në vijim, sjellim në vëmendje se Këshilli në mbledhjen e tij të datës 22.10.2024 me vendimin nr. 625, datë 22.10.2024, vendosi: “Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”; Gjithashtu, në kushtet kur znj. {...} ishte njëkohësisht edhe Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e po kësaj date,

Këshilli miratoi vendimin nr. 626, datë 22.10.2024 në të cilin u zgjodh z. Ilir Rusi si Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Tashmë përbërja e Këshillit është përtërirë me 1 (një) anëtar të ri të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 97, datë 17.10.2024, përkatësisht: znj. Violanda Theodhori, nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Me ripërtëritjen e Këshillit me një anëtar të ri, si edhe në të njëjtën kohë duke mbajtur në konsideratë përfundimin e mandatit të znj. {...}, e cila mbante njëkohësisht funksionin e Kryetares, vlerësohet e nevojshme një ripërtëritje e Komisioneve të Përhershme, duke pasur në vëmendje, vijueshmërinë e veprimtarisë së Këshillit, natyrën e çështjeve të trajtuara nga secili Komision, eksperiencën e secilit anëtar në raport me fushën e veprimtarisë së Komisionit si edhe shpërndarjen e drejtë të punës së secilit anëtar. Po ashtu në ndryshimin e propozuar, janë marrë në konsideratë parashikimet e nenit 63 të ligjit 115.

Sa më sipër, propozohet përbërja e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit si edhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pas ripërtëritjes së Këshillit me një anëtar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, të jetë si vijon:

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB)

Anëtarë:

1. Z. Ilir Rusi;
2. Z. Ridvan Hado;
3. Znj. Yllka Rupa.

Anëtarë zëvendësues:

1. Znj. Emona Muçi;
2. Z. Albens Tabaku.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP)

Anëtarë:

1. Znj. Irena Plaku;
2. Znj. Gentiana Muçaj;
3. Znj. Violanda Theodhori.

Anëtarë zëvendësues:

1. Z. Ridvan Hado;

2. Z. Bledar Bajri.

Struktura e projektvendimit:

Në pikën e parë të projektvendimit parashikohet ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 13, datë 18.01.2019 i KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar.

Gjithashtu në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar”,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

Pika 1 e vendimit nr. 13, datë 18.01.2019 i KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

1. Përbërja e Komisionit të Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit si edhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, të jetë si vijon:

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB)

Anëtarë:

1. Z. Ilir Rusi;
2. Z. Ridvan Hado;
3. Znj. Yllka Rupa.

Anëtarë zëvendësues:

1. Znj. Emona Muçi;
2. Z. Albens Tabaku.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP)

Anëtarë:

1. Znj. Irena Plaku;
2. Znj. Gentiana Muçaj;
3. Znj. Violanda Theodhori.

Anëtarë zëvendësues:

1. Z. Ridvan Hado;
2. Z. Bledar Bajri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.10.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (kryetar) |
| 2. Yllka Rupa | (zëvendëskryetare) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 8. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

10. Violanda Theodhori (anëtar)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra (në sallë), Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, përfaqësuese EWMI.

6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).

7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, par të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin përkatës është parashikuar ndër të tjera që autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjithë niveleve, është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në këtë proces të hetimit dhe verifikimit të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, parashikohet në pikën 4 të nenit 119 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin për të njoftuar ankuesin në çdo fazë të ecurisë së trajtimit të ankesës së tij, konkretisht duhet të njoftojë për vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit”.

Ndërkohë, në fjalinë e fundit të pikës 4, të nenit 119, parashikohet që: “... ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin e ankesës ashtu dhe vendimit për mbylljen e hetimit. Lidhur me trajtimin e këtyre ankesave, mbështetur në pikën 13 të nenit 62 të ligjit nr.115, KLGJ-ja ka detyrimin të krijojë një komision të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Me vendimin e tij nr. 170, datë 28.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngriti këtë Komision të Përkohshëm, si dhe me vendimin nr.171, datë 28.05.2020 përcaktoi përbërjen e tij.

Me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij Komisioni.

Nisur nga përcaktimi se ky Komision ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të përkohshme dhe se, në pikën 2 e vendimit nr.170, datë 28.05.2020, përcaktohet ndër të tjera se komisioni “do të ripërtërihet brenda muajit janar të çdo viti”.

Për sa më sipër, nisur nga rregullorja e këtij Komisioni të Përkohshëm, Këshilli me vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 ka miratuar përbërjen e Komisionit të

Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024” i cili u ndryshua me vendimin nr. 488, datë 13.09.2024 për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}.

Në vijim, në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 625, datë 22.10.2024, ka vendosur: 1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}. 2. Përfundimin e qëndrimit në detyrë të znj. sipërcituar më datë 17.10.2024, dhe me vendimin nr. 626, ka vendosur: Zgjedhjen e z. Rusi Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë rolin dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës është i nevojshëm ndryshimi i përbërjes së këtij Komisioni me një anëtar. Ky ndryshim propozohet të bëhet me short, nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, në përputhje me parashikimet e nenit 62, të ligjit nr.115 “Për qeverisjen”, i ndryshuar, i cili parashikon respektimin e raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë.

Në kushtet kur znj. Yllka Rupa është anëtare, njëkohësisht edhe Kryetare e këtij Komisioni të Përkohshëm dhe z. Bledar Bajri është anëtar zëvendësues, atëherë procedura e shortit do të zhvillohet ndërmjet anëtarëve të tjerë jogjyqtarë që janë z. Albens Tabaku dhe znj. Violanda Theodhori.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Nuk ka diskutime.

Ftoj administratën për përgatitjen dhe hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e dy anëtarëve jogjyqtarë: z. Albens Tabaku dhe znj. Violanda Theodhori.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Nga shorti rezultoi i përzgjedhur anëtari z. Albens Tabaku.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për projektvendimin e përditësuar dhe me rezultatet e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 10, datë 18.01.2024, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2024, është si më poshtë:

1. Znj. Yllka Rupa – kryetare;

2. Znj. Irena Plaku – anëtar;

3. Z. Albens Tabaku - anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Z. Markelian Koça – anëtar;

2. Z. Bledar Bajri – anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.10.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e këshilltarit të etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (kryetar)
2. ***Yllka Rupa*** (zëvendëskryetare)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
8. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Violanda Theodhori*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra (në sallë), Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese EWMI.*
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e këshilltarit të etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e këshilltarit të etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, par të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju parashtroj relacionin për hapjen thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e këshilltarit të etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Detyrimi për të ruajtur e treguar etikë profesionale dhe siguruar pavarësi në nivel institucional dhe individual, është përgjegjësi personale e çdo magjistrati. Kjo

përgjegjësi vlen si për jetën profesionale gjatë ushtrimit të funksionit, por edhe në jetën private të magistratit. Në funksion të ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek drejtësia, në çdo kohë magistratët duhet të kenë një qasje profesionale dhe etike që jo vetëm është, por edhe duket si e tillë.

Dispozitat ligjore të ligjit “Për statusin” i ngarkojnë një rol aktiv magistratëve, duke kërkuar nga ana e tyre marrjen e të gjitha masave për të lartësuar reputacionin e organeve të drejtësisë. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes për gjyqtarët miratohen dhe publikohen nga KLGJ-ja. Konkretisht në nenin 83 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikohet detyrimi i KLGJ-së për miratimin dhe publikimin e rregullave të etikës gjyqësore si dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme të tyre. Në përmbushje të detyrimit ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar rregullat e etikës, të përmbledhura në Kodin e Etikës, miratuar me vendimin nr.171, datë 22.04.2021. Për shkak të rëndësisë që ka etika dhe çështjet rreth saj, në dispozitën e mësipërme është parashikuar gjithashtu caktimi i një Këshilltari për Etikën nga radhët e gjyqtarëve, i cili në rast të një ngarkese të justifikuar pune mund të shërbejë në këtë pozicion me kohë të plotë. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare dhe ka të drejtë të rizgjidhet vetëm një herë në këtë pozicion.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.208, datë 11.10.2019 ka vendosur, caktimin e znj. {...} në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, në atë kohë gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, sot gjyqtare në Gjykatën e Lartë pa shkëputje nga detyra e gjyqtarit. Referuar datës së vendimmarrjes së Këshillit, rezulton se aktualisht mandati i gjyqtares së caktuar në detyrën e Këshilltares së Etikës ka përfunduar në datë 11.10.2024.

Në datën 14.10.2024, në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar shkresa për raportimin e punës si dhe shprehje interesi për t’u rizgjedhur në pozicionin e Këshilltarit të Etikës për një mandat tjetër 5-vjeçar, nga znj. {...}, ku ndër të tjera, bashkë me shprehjen e interesit për këtë pozicion, ka bërë edhe një përmbledhje të punës së saj 5-vjeçare, ku ka relatuar se ka qenë pjesë e programit për miratimin e Kodit të Etikës; Hartimin e dy opinioneve në lidhje me çështjet: 1. Përdorimi i telefonit celular dhe kufijet e përdorimit të rrjeteve sociale; dhe bashkëpunimi me projektin e BE-së për “Përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të drejtësisë”, ku janë

ndërmarrë hapa konkrete që në këtë rast është për hartimin e një manuali për çështjet e etikës.

Në nenin 83 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon se: “Këshilli cakton një Këshilltar të Etikës nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe që kanë përvojë dhe njohuri të veçanta mbi çështje të etikës. Këshilltari i Etikës shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. [...]”.

Aktualisht, mandati 5-vjeçar i znj. {...} si Këshilltare e Etikës ka përfunduar në datë 11.10.2024. Në këto kushte, për Këshillin lind detyrimi ligjor për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës për një mandat tjetër 5-vjeçar. Me qëllim përzgjedhjen e një gjyqtari, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson të hapë thirrjen për paraqitjen e kërkesave për t’u caktuar në detyrën e Këshilltarit, duke iu drejtuar gjyqtarëve të cilët plotësojnë kushtet për t’u caktuar në këtë detyrë.

Për shkak të natyrës së detyrave që do të kryejë Këshilltari i Etikës, kriteret kualifikuese për këtë pozicion janë të larta dhe ekuivalente me kushtet ligjore që duhet të plotësojë një magjistrat për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë. Detyrat e Këshilltarit për Etikën konsistojnë kryesisht në këshillimin e çështjeve të diskutueshme të etikës të ngritura me kërkesë nga ana e gjyqtarëve, hartimin e përditësimin e manualeve zbatuese që orientojnë për zgjidhjen e situatave të ndryshme kur aspekte të etikës janë të diskutueshme, ndërveprimin me Shkollën e Magjistraturës si dhe ndërveprimin me KLGJ dhe raportimin periodik përpara tij. Pozicioni i Këshilltarit të Etikës është parashikuar në funksion të përmirësimit të standardeve të etikës në radhët e gjyqësorit jo vetëm nëpërmjet ofrimit të këshillimit për gjyqtarët, por edhe ofrimit të mundësive për zbatimin uniform të rregullave të sjelljes. Këshilltari i Etikës ushtron veprimtarinë vetëm në funksion të nevojave të gjyqtarëve për këshillim dhe është i detyruar të mbajë konfidencialitetin e komunikimeve me gjyqtarin. Nga ana tjetër detyra e Këshilltarit të Etikës, nuk është e lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë që ushtrojnë funksione vlerësimi e inspektimi, madje nuk i lejohet t’i japë informacion këtyre organeve.

Në këtë kuadër, pozicioni dhe roli i Këshilltarit të Etikës është shumë i rëndësishëm, prandaj veç kushteve ligjore të parashikuar në nenin 83, siç është vjetërsia dhe përvoja në çështje të etikës, gjyqtari që caktohet në këtë pozicion duhet të shfaqë vetë aftësi të shkëlqyera etike dhe morale dhe të këtë një reputacion mes kolegëve por edhe për publikun, që e bën jo vetëm të besueshëm, por i shërben edhe ngritjes së reputacionit të sistemit të drejtësisë.

Komisioni, duke marrë parasysh nevojat që ka aktualisht sistemi gjyqësor për gjyqtarë në detyrë si dhe ngarkesën aktuale të punës në Këshill, vlerëson se caktimi i një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës, vazhdon të mos jetë e nevojshme të bëhet me kohë të plotë, e për pasojë të ndiqen procedurat për caktimin e tij. Aktualisht vlerësohet se funksionet e Këshilltarit të Etikës mund të kryhen prej gjyqtarit që do të caktohet, paralelisht me ushtrimin e funksionit gjyqësor.

Në nenin 83 të ligjit “Për organet e qeverisjes”, është parashikuar që Këshilltari i Etikës, duhet të plotësojë kushtet ligjore për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë. Në zbatim të nenit 136 të Kushtetutës, nenit 32, 47 dhe 48 të ligjit “Për statusin”, gjyqtari që caktohet në këtë pozicion, duhet të ketë jo vetëm përvojë profesionale si gjyqtar mbi 13 vjet, por duhet të ketë kaluar me sukses edhe procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Veç këtyre kriterëve ligjore, parashikohet që gjyqtari duhet të ketë përvojën dhe njohuri për çështjet e etikës.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 83 pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për hapjen e thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Struktura e projektvendimit është si më poshtë:

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet hapja e thirrjes për paraqitjen e kërkesave për caktimin e një gjyqtari në detyrën e Këshilltarit të Etikës, pa shprehur nga ushtrimi i detyrës.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se afati i paraqitjes së kërkesës për caktimin në pozicionin e Këshilltarit të Etikës, i cili mund të përcaktohet në një datë fikse (të paktën 15 ditë nga mbledhja) ose dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni që kandidati duhet të dorëzojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun e dytë, përcaktohet kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës, që është 5 vjet dhe përfiton një trajtim financiar 5 % shtesë page (pika e parë).

Në pikën 2 përcaktohen kushtet dhe kriteret ligjore për t'u caktuar në detyrën e Këshilltarit të Etikës.

Parashikohet si dhe vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

(Zonja Plaku propozon pa ndezur mikrofonin, se afati i paraqitjes së kërkesës të jetë data 13.11.2024.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim edhe afati u propozua nga relatorja 13.11.2024.

Atëherë, keni diskutime edhe me përditësimin e këtij akti sipas propozimit të bërë nga relatorja në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesave që do jetë datë 13.11.2024, ditë e mërkurë?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e thirrjes për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e këshilltarit të etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relatimit dhe propozimit të bërë në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesës për caktimin në pozicionin e Këshilltarit të Etikës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.10.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e kandidatëve për magjistratë dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------|---------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (kryetar) |
| 2. Yllka Rupa | (zëvendëskryetare) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 8. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Violanda Theodhori | (anëtar) |

21

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 29.10.2024 (Pika 4)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra (në sallë), Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese EWMI.*
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e kandidatëve për magjistratë dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në listën e kandidatëve për magjistratë dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024”, par të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Ilir Rusi: Po në vijim të kësaj mbledhjeje zoti Kurushi kërkon fjalën.

Po, më thuaj?

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Shkurtimisht, meqenëse ne miratuar përbërjen e Komisioneve dhe tashmë Komisionet janë të strukturuar, unë do propozoj që në mbledhjen e ditës së sotme, në rend të ditës, të përfshihej edhe një projektvendim i radhës, që ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024. Ky propozim lidhet me një projektvendim për ndryshimin e një vendimi nr. 375, datë 13.07.2024 (*lapsus, viti 2023*). Do ndryshohet relatori i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidatët magjistratë, jo të këtij viti akademik, por të vitit që ka kaluar, pra të vitit 2023-2024.

Meqenëse Komisionet janë të plota, unë e parashtroj si propozim për t'u shqyrtuar edhe ky projektvendim ditën e sotme, për efekt edhe të kohës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Atëherë, kemi një parashtresë nga z. Kurushi për të shtuar një çështje tjetër në këtë rend dite, që ka të bëjë me atë për të cilën edhe kjo mbledhje u bë me njoftimin e djeshëm për ditën e sotme, për funksionalitetin e Këshillit, dhe ka të bëjë me: projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, i ndryshuar.

Keni diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Jo!

Atëherë e hedhim në votim propozimin e z. Kurushi për të shtuar këtë çështje në këtë rend dite.

Yllka Rupa: Pro propozimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë do të kemi edhe një pikë të pestë në këtë rend dite.

Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në listën e kandidatëve për magistratë dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Relatore është zonja Plaku.

Ndërkohë administrata të bëjë gati materialet dhe t’ia sjellë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me çështjen që u shtua për shqyrtim në këtë rend dite.

Zonja Plaku, fjala për ju për pikën 4.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po parashtroj relacionin përkatës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 33 të ligjit “Për statusin”, i ndryshuar, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, për vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 301, datë 18.06.2024 Këshilli ka proceduar me caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, për një periudhë 3-vjeçare, përkatësisht për periudhën 2024 - 2027, të ndryshuar me vendimin nr.334, datë 09.07.2024.

Me vendimin nr. 485, datë 28.08.2024 Këshilli ka caktuar gjykatat dhe gjyqtarët udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, për vitin kalendarik 2024-2025, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për katër mujorin e parë, të dytë dhe të tretë.

Rezulton se një nga gjyqtarët udhëheqës të caktuar për kandidatët për magistratë të këtij viti kalendarik është gjyqtarja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila me vendimin nr. 591, datë 09.10.2024 të

24

Këshillit të Lartë Gjyqësor është ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, efektet e të cilës fillojnë më datë 21.10.2024.

Gjithashtu, rezulton se edhe gjyqtarja {...} është caktuar gjyqtar udhëheqës për kandidatët për magjistratë, por kjo e fundit ka ndryshuar seksionin, referuar vendimit të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke u caktuar tashmë në seksioni civil/tregtar.

Po kështu, rezulton se edhe dy nga gjyqtarët udhëheqës të caktuar për kandidatët për magjistratë gjatë vitit akademik janë gjyqtarët {...} dhe {...}, gjyqtare të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilat me vendimet e Këshillit janë caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për një periudhën 2-vjeçare.

Referuar parashikimeve të nenit 33, të ligjit “Për statusin”, si dhe ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është Këshilli i Lartë Gjyqësor që jo vetëm përcakton trupën e magjistratëve gjyqtarë udhëheqës për kryerjen e detyrave profesionale për kandidatët për magjistratë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në ligj, por edhe përditëson trupën e miratuar, në rastet kur magjistratët e miratuar, gjenden në pamundësi për të ushtruar/përmbushur këtë funksion.

Në kushtet kur siç relatuam më sipër këta gjyqtarë janë në pamundësi për të ushtruar funksionin si mentorë për magjistratët e vitit 2024-2025, sipas listës së gjyqtarëve, kemi propozuar, referuar listës së miratuar, kemi propozuar ndryshimin e këtij vendimi.

Referuar listës së miratuar të gjyqtarëve udhëheqës për vitin akademik 2024-2025 të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se gjithë gjyqtarët janë të angazhuar duke u caktuar pranë tyre nga dy apo tre kandidatë për magjistratë, për shkak se për vitin akademik 2024-2025 numri i kandidatëve është më i lartë se numri i gjyqtarëve udhëheqës që ushtrojnë funksionin në Gjykatën Administrative. Në këto kushte, zëvendësimi i gjyqtarëve udhëheqës {...} dhe {...} në sesionin e dytë dhe tretë të 4-mujorit të praktikës profesionale dikton nevojën e caktimit të 3 apo 4 kandidatëve, në të dy sesionet në të cilat do të kryhet zëvendësimi.

Gjithashtu, në datë 09.10.2024 dhe në datë 10.10.2024 janë protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dy kërkesa/shkresa të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, me lëndën; vënien në dijeni për përjashtimin e dy kandidatëve për magjistratë, ku

rezulton se është përjashtuar zonja {...} dhe {...}. Konkretisht janë referuar edhe vendimet përkatëse.

Në këto kushte, duke qenë se këta shtetas nuk gëzojnë më statusin e kandidatëve për magjistratë, ata do përjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale për vitin e tretë për këtë katërmujor.

Për këto arsye, KVEVP-ja (*komisioni*) vlerëson se ka vend për zëvendësimin e gjyqtarëve udhëheqës. Janë përcaktuar edhe kandidatët, që nuk po i lexoj. I keni në projektvendim, duke cituar dhe kandidatët për magjistratë të cilët do zëvendësohen.

Angazhimi i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative, në të dyja sesionet, të caktuar pranë tyre do jenë 3 apo 4 kandidatë për gjyqtarë, është i kushtëzuar nga fakti që në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën kryejnë praktikën profesionale 31 (tridhjetë e një) kandidatë për gjyqtarë, të ndarë në dy periudha 4-mujore, ushtrojnë detyrën 6 (gjashtë) gjyqtarë nga të cilët, pas caktimit në skemë delegimi të znj. {...} dhe znj. {...}, mbeten 4 (katër) gjyqtarë të cilët janë të përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës. Ndërkohë që numri i kandidatëve është 31 (tridhjetë e një).

Gjithashtu, KVEVP-ja vlerëson se ka vend për ndryshimin e vendimit nr. 485, datë 28.08.2024 në lidhje me kandidatët për magjistratët e caktuar, duke përjashtuar nga lista e magjistratëve të cilët do të kryejnë praktikën profesionale gjatë periudhës 2024-2025.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. 485 (*datë 28.08.2024*) “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2024-2025”, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës (a) {...} me gjyqtarin {...} për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025) dhe me gjyqtaren {...} për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025); (b) gjyqtaren udhëheqëse {...} me gjyqtaren {...} për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024-shkurt 2025) dhe me gjyqtarin {...} për sesionin [...], – mos t’i lexoj të gjitha se i keni aty.

Në pikën 2 të projektvendimit, është parashikuar përjashtimi nga lista e kandidatëve për magjistratë që do të kryejnë praktikën profesionale për periudhën 2024-2025.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet njoftimi i Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Parashikohet momenti i hyrjes në fuqi menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit, referuar parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në listën e kandidatëve për magjistratë dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 28.08.2024 gjatë praktikës

27

profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2024-2025, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës:

a) {...} me gjyqtarët:

i. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025) dhe;

ii. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025);

b) {...} me gjyqtarët:

i. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025) dhe;

ii. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025);

c) {...} me gjyqtarët:

i. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatëve për magistratët {...}, {...} dhe {...} për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025);

ii. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatëve për magistratë {...} dhe {...} për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025) dhe;

iii. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...} për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025).

d) {...} me gjyqtarët:

i. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025);

ii. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...} për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2024 – shkurt 2025) dhe {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025);

iii. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2025).

2. Përjashtimin nga lista e kandidatëve për magistratë që do të kryejnë praktikën profesionale gjatë periudhës 2024-2025, të z. {...} dhe të znj. {...}.

3. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Shkallës së Parë

të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.10.2024)

Pika 5 shtesë¹ e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Ilir Rusi** (kryetar)
2. **Yllka Rupa** (zëvendëskryetare)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Bledar Bajri** (anëtar)

¹ Shih fillimin e procesverbalit të pikes 4 ku edhe u miratua trajtimi i kësaj pike shtesë.

8. *Albens Tabaku* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Violanda Theodhori* (anëtar)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra (në sallë), Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese EWMI.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Në vijim po vazhdojmë me atë çështje që u shtua përgjatë kësaj mbledhjeje, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin relacioni është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Kryetar!

Bashkëlidhur projektvendimit, pa humbur kohë, po bëj një prezantim të relacionit që lidhet me një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2024 (*lapsus, viti 2023*). Ky relacion është përgatitur dhe po prezantohet ditën e sotme edhe për shkak të ndryshimit që është bërë në përbërjen e Komisioneve të Përhershme, vendim që është marrë në këtë ditë të sotme dhe si çështje ishte si çështje e parë e renditur në rendin e ditës.

Me vendimin nr. 375, datë 13.07.2023, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024. Në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, u caktua si relator z. {...}.

Referuar sa më lart, bazuar në vendimit nr. 738, datë 12.12.2023 “Për deklarinimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}”, Këshilli vendosi, me vendimin nr. 12, datë 18.01.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, si më poshtë: Caktimin e z. {...}, si relator për kandidaten znj. {...}.

Ju kujtojmë në atë kohë anëtari i tretë që plotësoi Komisionin e Zhvillimit të Karrierës ishte z. Markelian Koça. Por për shkak se gjatë asaj kohe zoti Koça nuk kishte certifikatën e sigurisë, çështjet që i mbetën z. {...} u hodhën në short midis z. {...} edhe unë, domethënë u vendosën midis nesh.

Më tej Komisioni i plotësua edhe me anëtarin e tretë që kishte mundësi dhe akses për të vijuar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore për kandidatët magjistratë në profilin gjyqtarë, në vitet akademike që ata janë pranuar në Shkollën e Magjistraturës.

Më tej, në mbledhjen plenare të datës 29.07.2024, me vendimin nr. 361, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi deklarinimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të tij, z. {...}. Vendimi i mësipërm hyri në fuqi menjëherë. Bazuar në dosjet dhe materialet e ish-anëtarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. {...} rezultoi që kandidatët për formimin fillestar sipas qëndrimit të mbajtur nga Këshilli (më pas kemi qëndrimin që

32

anëtari i Komisionit jomagjistrat nëse do kishte shkaqe papajtueshmërie, dosjet e tij do t'i merrte në proces verifikimi anëtari tjetër jomagjistrat, ndërsa nëse do të kishte shkak papajtueshmërie anëtari magjistrat, dosjet e tij do t'i merrte anëtari tjetër magjistrat). Ndodhur pra në këtë situatë kur z. {...} iu deklarua përfundimi i mandatit, dosjet e tij i kaluan anëtarit zëvendësues jomagjistrat, z. Ilir Rusi. Konkretisht ishin dy dosje. Dosja për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidates për magjistrate znj. {...} dhe kandidatja e dytë ishte znj. {...}. Kjo e fundit me vendimin nr. 470 datë 31.07.2024 është kualifikuar dhe relator ka qenë z. Rusi.

Në mbledhjen e datës 13.09.2024, Këshilli me vendimin nr. 486, "Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të Këshillit vendosi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme, duke bërë edhe ndryshimet e mëposhtme: Përbërja e Komisioneve të Përhershme vijon si më poshtë:

Për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës anëtarët ishin dhe janë:

1. Z. Klodian Kurushi;
2. Z. Markelian Koça;
3. Z. Albens Tabaku.

Anëtarë zëvendësues janë:

1. Znj. Emona Muçi;
2. Znj. Yllka Rupa.

Në mbledhjen e datës 22.10.2024, me vendimin nr. 625, datë 22.10.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi "Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}". Me vendimin nr. 626, datë 22.10.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi "Zgjedhjen e z. Ilir Rusi Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Referuar sa më lartë si dhe bazuar në nenin 63, pika 2 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", theksohet se "Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator në çështje me natyrë individuale". Kështu që ndodhur në këto kushte, duke qenë në një shkak papajtueshmërie ligjore për të qenë relatori Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndodhur në këto kushte ne përgatisim relacionin e radhës që dosja e cila ka qenë në relativim nga z. Rusi përpara se sa ai të bëhej Kryetar, dhe pasi ai është bërë Kryetar nuk duhet të vijojë më tej relacioni nga zoti Rusi për shkak se si ka pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; ndodhur në këto kushte ne bëjmë propozimin e

radhës që kjo dosje të kalojë relatorit që është anëtar zëvendësues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, anëtar që vjen nga radhët e jomagjistratëve. Pra propozimi është që kjo dosje të shkojë për të vijuar më tej verifikimin nga zonja Yllka Rupa.

Këto janë propozimet tona.

Projektvendimi është i parashtruar dhe ka dy pika:

Pika e parë e projektvendimit është caktimi i relatorit për kandidaten znj. {...} –
relatore znj. Yllka Rupa.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidates për zëvendësimin e relatorit.

Faleminderit!

Këto janë propozimet.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Yllka Rupa: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Violanda Theodhori: Dakord.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 11, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidates z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Me shqyrtimin e kësaj çështjeje mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor